LIGJ
Nr. 31/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR SHTESËN E FINANCIMIT PËR PROJEKTIN E BURIMEVE UJORE DHE UJITJES DHE TË MARRËVESHJES PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË BURIMEVE UJORE DHE UJITJES

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

1. Ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ratifikimin e marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 31.5.2018

Shpallur me dekretin nr. 10809, datë 8.6.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

Banka Botërore
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM
GRUPI I BANKËS BOTËRORE

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE
Rruga "Ibrahim Rugova", nr. 34
Tiranë, Shqipëri

MARYAM SALIM
Menaxher vendi
Shqipëri

8 mars 2018

Shkëlqesisë së Tij Arben Ahmetaj
Ministër
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë
Shqipëri

I nderuar z. Ministër:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes
Ndryshim i Marrëveshjes së Huas
(Huaja nr. 8211-AL)

I referohemi Marrëveshjes së Huas (Marrëveshja) për Projektin e sipërpërmendur, të datës 14 dhjetor 2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), me ndryshimet pasuese.

Kemi kënaqësinë të biem dakord të ndryshojmë këtë Marrëveshje si më poshtë:

1. Seksioni 3.01

Akronimi "MBUMK" fshihet dhe zëvendësohet me akronimin "MBZHR", siç përkufizohet në Shtojcën e Marrëveshjes që tregohet më poshtë.

2. Grafiku 1, Përshkrimi i Projektit

Objektivi i zhvillimit të Projektit ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

"Objektivi i Projektit është: i) ngritja e një kuadri strategjik për të menaxhuar burimet ujore në nivel vendi dhe në nivelin e shtretërve të lumenjve të Drinit–Bunës dhe Semanit; dhe ii) përmirësimi i dhënies së shërbimit të ujitjes në Sistemet e Zgjedhura të Ujitjes."

3. Grafiku 2, Ekzekutimi i Projektit

Seksioni I.(c), seksioni C.1,3,4, 5 dhe 6, seksioni II.A.1, B.2 dhe seksioni V.1 dhe 2

Akronimi "MBUMK" fshihet dhe zëvendësohet me akronimin "MBZHR", siç përkufizohet në shtojcën e Marrëveshjes që tregohet më poshtë.

Seksioni IV.A.2: Tabela ndryshohet dhe zëvendësohet në tërësinë e vet siç reflektohet në shtojcën e kësaj letre; dhe

Seksioni IV.B.2: Data e mbylljes shtyhet deri më 31 maj 2020.

4. Shtojcë

Seksioni I.12 dhe 13

Akronimi "MBUMK" fshihet dhe shtohet një pikë e re 12 me këtë tekst:

"MBZHR" është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Huamarrësit dhe çdo pasues i saj.

Të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes, të cilat nuk kanë ndryshuar, mbeten të pandryshuara dhe në fuqi.

Ju lutem, shprehni pëlqimin tuaj për sa më sipër, në emër të Huamarrësit, duke nënshkruar dhe duke vendosur datën në dy kopjet origjinale të kësaj letre dhe duke na kthyer një kopje origjinale të nënshkruar. Ky ndryshim hyn në fuqi nga data në të cilën Banka merr njoftimin e Huamarrësit në lidhje me përmbushjen e të gjitha procedurave të brendshme.

Me respekt,

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
Nga: _____
Linda van Gelder
Drejtore për Shqipërinë

KONFIRMUAR NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Nga: ARBEN AHMETAJ
Përfaqësues i Autorizuar

Datë: 18.4.2018
Bashkëlidhur: Shtojca
Tel: +355 42280 650/51 Faks: +355 42240 590

SHTOJCË
TËRHEQJA E FONDEVE TË HUAS

Kategoria	**Shuma e Huas (e shprehur në euro)**	**Përqindja e shpenzimeve të financuara (duke zbritur taksat) sipas Huas**
1. Mallra, punime, shërbime jokonsulence, shërbime konsulence dhe trajnime a) Pjesa 3 Projektit (përveç mallrave për pjesën 3(c) b) Pjesë të tjera të Projektit	 48,411 30,136,527	 100% 100%
2. Shpenzime Operative Shtuese	90,000	100%
3. Rimbursimi i paradhënies për përgatitjen e Projektit	407,562	Shumë e pagueshme në pajtim me seksionin 2.07(a) të kushteve të përgjithshme
4. Tarifa e përgjithshme	77,500	Shumë e pagueshme në pajtim me seksionin 2.05(a) të kushteve të përgjithshme
TOTALI	**31,000,000**	

THE WORLD BANK
IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

WORLD BANK GROUP OFFICE
"Ibrahim Rugova" Street, No. 34
Tirana, Albania

MARYAM SALIM
Country Manager
Albania

March 8, 2018

H.E. Arben Ahmetaj
Minister
Ministry of Finance and Economy
Tirana, Albania

Dear Mr. Minister,

REPUBLIC OF ALBANIA: Water Resources and Irrigation Project
Amendment to the Loan Agreement (Loan No. 8211-AL)

We refer to the Loan Agreement (the Agreement) for the above-mentioned Project dated December 14, 2012, between the Republic of Albania (the Borrower) and the International Bank for Reconstruction and Development (the Bank), as amended to date.

We are pleased to agree to amend the Agreement as follows:

1. **Section 3.01**

The acronym "MARDWA" is deleted and replaced with the acronym "MARD" as defined under the Appendix to the Agreement as reflected below.

2. **Schedule 1, Project Description**

The Project Development Objective is hereby amended to read as follows:

"The objective of the Project is to: (i) establish the strategic framework to manage water resources at the national level and at the level of the Drin-Buna and Semani River basins; and (ii) improve irrigation service delivery in Selected Irrigation Systems."

3. **Schedule 2, Project Execution**

Section I.(c), Section C.1,3,4, 5 and 6, Section II.A.1, B.2 and Section V.1 and 2

The acronym "MARDWA" is deleted and replaced with the acronym "MARD" as defined under the Appendix to the Agreement as reflected below.

Section IV.A.2: The table is hereby amended and replaced in its entirety as reflected in the Annex to this Letter; and

Section IV.B.2: The Closing Date is being extended to May 31, 2020.

4. **Appendix**

Section I.12 and 13

Tel: +355 42280 650/51 Fax: +355 42240 590

The acronym "MARDWA" is deleted and a new 12 is inserted to read:
"MARD" means the Borrower's Ministry of Agriculture and Rural Development and any successor thereto.

All other provisions of the Agreement, except as herein amended, shall remain in full force and effect.

Please indicate your agreement to the foregoing, on behalf of the Borrower, by countersigning and dating two original copies of this letter and returning one countersigned original to us. This amendment shall become effective as of the date of upon which the Bank receives the Borrower's notice regarding the fulfillment of all its internal procedures.

Very truly yours,

INTERNATIONAL BANK FOR RECONSTRUCTION AND DEVELOPMENT

By _____
Maryam Salim
Country Manager
Republic of Albania

CONFIRMED ON BEHALF OF THE REPUBLIC OF ALBANIA

By: ORBEN AHMETAJ
Authorized Representative

Date: 18/4/2018

Attachment: Annex

"Withdrawal of the Proceeds of the Loan

Category	Amount of the Loan (expressed in Euro)	Percentage of Expenditures Financed (exclusive of taxes) under the Loan
(1) Goods, works, non-consulting services, consultants' services and training		
a. Part 3 of the Project (except for Goods for part 3(c)	48,411	100%
b. Other Parts of the Project	30,136,527	100%
c. Goods for Part 3(c) of the Project	240,000	45%
(2) Incremental Operating Costs	90,000	100%
(3) Refund of Project Preparation Advance	407,562	Amount payable pursuant to Section 2.07(a) of the General Conditions
(4) Front End Fee	77,500	Amount payable pursuant to Section 2.05(a) of the General Conditions
TOTAL	**31,000,000"**	

NUMRI I HUAS 8817-AL

MARRËVESHJE HUAJE
(FINANCIM SHTESË PËR PROJEKTIN E BURIMEVE UJORE DHE UJITJES) NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

MARRËVESHJE HUAJE

MARRËVESHJE nga data e nënshkrimit ndërmjet REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (Huamarrësi) dhe BANKËS NDËRKOMBË-TARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (Banka).

Duke pasur parasysh se: A) sipas një Marrëveshjeje të datës 14 dhjetor 2012 ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës (Marrëveshja fillestare e Huas), Banka ra dakord t'i jepte Huamarrësit një hua (Huaja fillestare) në një shumë të barabartë me tridhjetë e një milionë euro (31,000,000 euro) për të asistuar në financimin e Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, sipas përshkrimit në pjesën 1 të Marrëveshjes së Huas (Projekti fillestar); dhe

B) Huamarrësi i ka kërkuar Bankës t'i japë një financim shtesë në mbështetje të aktiviteteve në vazhdim në lidhje me pjesët 1, 2 dhe 4 të Projektit fillestar, siç përshkruhet plotësisht dhe ritheksohet në pjesën 1 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti), duke i vënë në dispozicion Huamarrësit një hua shtesë (Hua shtesë);

Duke pasur parasysh se: Banka ka rënë dakord, bazuar, ndër të tjera, nga sa më sipër për t'i dhënë këtë Hua shtesë Huamarrësit si më poshtë:

Neni 1
Kushte të përgjithshme; përkufizime

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç përcaktohen në shtojcën bashkëlidhur kësaj Marrëveshje) zbatohen dhe janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Me përjashtim të rasteve kur kërkohet ndryshe nga konteksti, termat që fillojnë me germë të madhe, të përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u janë dhënë në kushtet e përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit shumën prej 23,000,000 euro (njëzet e tre milionë euro) (Huaja) për të asistuar në financimin e projektit të përshkruar në pjesën 1 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti).

2.02 Huamarrësi mund t'i tërheqë fondet e Huas në përputhje me seksionin III të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa "fillestare" Komisioni i Huas është një e katërta e një për qind (0.25%) e shumës së Huas.

2.04 Tarifa e angazhimit është një e katërta e një për qind (0.25%) në vit e balancës së patërhequr të Huas.

2.05 Norma e interesit është Norma e Referencës plus Norma Fikse sipas seksionit 3.02(e) të kushteve të përgjithshme.

2.06 Datat e pagesës janë 1 maj dhe 1 nëntor të çdo viti.

2.07 Shuma principale e Huas shlyhet në përputhje me pjesën 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3
Projekti

3.01. Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për objektivin e Projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të zbatojë Projektin nëpërmjet MBZHR-së, në përputhje me dispozitat e nenit V të kushteve të përgjithshme dhe pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4
Hyrja në fuqi

4.01 Kushti shtesë i hyrjes në fuqi përbëhet nga sa më poshtë, d.m.th., që Huamarrësi të ketë përditësuar dhe përshtatur Manualin Operacional të Projektit të përgatitur në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

4.02 Afati i hyrjes në fuqi është data nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së nënshkrimit.

Neni 5
Përfaqësuesi, adresat

5.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është ministri i tij i Financave dhe Ekonomisë ose çdo pasues i tij.

5.02 Për qëllimet e seksionit 10.01 të kushteve të përgjithshme: (a) Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
Tiranë, Shqipëri
dhe

Adresa elektronike e Huamarrësit është:
Faks:
355 42228494
sekretariamin@financa.gov.al

Për qëllimet e seksionit 10.01 të kushteve të përgjithshme: (a) Adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America; dhe

Adresa elektronike e Bankës është:

Teleks:	Faks:
248423(MCI) ose	1-202-477-6391
64145(MCI)	

Rënë dakord nga data e nënshkrimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

_____

Nga
Përfaqësuesi i Autorizuar
Emri: ARBEN AHMETAJ
Titulli: MINISTËR
Data:19.3.2018

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga

_____

Përfaqësuesi i Autorizuar
Emri: MARYAM SALIM
Titulli: MENAXHER VENDI
Datë: 19 MARS 2018

PJESA 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i Projektit është të: i) krijojë kuadrin strategjik të menaxhimit të burimeve ujore në nivel kombëtar dhe në nivelin e baseneve të lumenjve të Drinit–Bunës dhe Semanit; dhe ii) përmirësojë ofrimin e shërbimit të ujitjes në sistemet e përzgjedhura të ujitjes.

Projekti përbëhet nga Projekti fillestar, pjesët e të cilit janë riparaqitur më poshtë për lehtësi reference:

Pjesa 1. Rehabilitimi i digave dhe i sistemeve të ujitjes dhe kullimit

a) Rehabilitimi dhe modernizimi i digave dhe i sistemeve të përzgjedhura të ujitjes dhe kullimit.

b) (i) Përgatitja dhe zbatimi i instrumenteve dhe masave të sigurisë të lidhura me aktivitetet e rehabilitimit dhe të modernizimit sipas pjesës 1(a) më lart, duke përfshirë planet e menaxhimit të mbrojtjes mjedisore dhe sociale dhe planet e veprimit për rivendosjet, kur janë të zbatueshme; dhe (ii) forcimi i kuadrit që rregullon sigurinë e digave bujqësore, duke përfshirë shtimin e kapaciteteve, rritjen e ndërgjegjësimit dhe përgatitjen e planeve për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit dhe sigurimin e cilësisë, instrumentet, operimin dhe mirëmbajtjen, dhe përgatitjen për rastet e emergjencave.

Pjesa 2. Mbështetja institucionale për ujitjen dhe kullimin

a) Përcaktimi i përgjegjësive për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes dhe kullimit ndërmjet grupeve të interesit (duke përfshirë ministritë, bordet e kullimit, njësitë e qeverisjes vendore, organizatat e përdoruesve të ujit dhe operatorët privatë), *ndër të tjera:*

i. përgatitjes së një strategjie kombëtare për ujitjen dhe kullimin;

ii. zhvillimit të marrëdhënieve bashkëpunuese (përfshirë marrëdhëniet kontraktuale) ndërmjet agjencive, të cilat përfshihen në ofrimin e shërbimeve të konsulencës;

iii. zhvillimit dhe formalizimit të standardeve të ofrimit të shërbimit të ujitjes dhe kullimit;

iv. zhvillimit dhe zbatimit të projekteve të vogla pilot të partneritetit publik privat, duke përfshirë delegimin e operimit dhe mirëmbajtjes së skemave të ujitjes dhe kullimit tek operatorët privatë.

b) Forcimi i kapaciteteve të organizatave që ofrojnë shërbime ujitjeje dhe kullimi dhe të kapaciteteve të grupeve të interesit (duke përfshirë ministritë, bordet e kullimit, njësite e qeverisjes vendore, organizatat e përdoruesve të ujit, dhe operatorët privatë), *ndër të tjera,* nëpërmjet sigurimit të bazës materiale dhe trajnimit në zonat e përzgjedhura, ku përfshihen menaxhimi i kontratave dhe kontraktimi me operatore të tjerë, administrimi, menaxhimi financiar, prokurimi, menaxhimi dhe përdorimin e ujit, dhe mirëmbajtjen.

Pjesa 3. Mbështetja institucionale për menaxhimin e integruar të burimeve ujore

Përcaktimi i një kuadri strategjik për menaxhimin e burimeve ujore, ndër të tjera:

a) Përgatitjes së një strategjie kombëtare të menaxhimit të integruar të burimeve ujore duke përfshirë krijimin e një forumi të grupeve të interesit për dialog ndërsektorial dhe vendimmarrje nën mbështetjen e Këshillit Kombëtar të Ujit; dhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, të tillë si: Këshilli Kombëtar i Ujit dhe Sekretariati i tij Teknik dhe këshillat e

baseneve të lumenjve dhe agjencitë e baseneve të lumenjve Drini–Buna dhe të Semanit.

b) Përgatitjes së planeve të menaxhimit të baseneve të lumenjve Drin–Buna dhe Semani, duke përfshirë identifikimin e masave strukturore dhe jostrukturore për përmirësimin e cilësisë së menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe për të forcuar kapacitetin për të zbatuar planet e përmendura nëpërmjet ofrimit të trajnimit dhe mallrave për agjencitë e basenit lumor dhe për rehabilitime të vogla të zyrave të tyre.

c) Krijimit të një baze të konsoliduar të dhënash për burimet ujore, për t'u përdorur si bazë për planifikimin dhe programimin kombëtar të burimeve ujore.

Pjesa 4. Mbështetja për zbatim

Ofrimi i mbështetjes për zbatimin e Projektit, duke përfshirë ofrimin e ndihmës teknike, trajnimin, bazën materiale, krijimin dhe zbatimin e një sistemi të menaxhimit të informacionit bazuar në performancë.

PJESA 2
ZBATIMI I PROJEKTIT

Seksioni I. Kuadri i zbatimit

A. Kuadri institucional

1. Huamarrësi siguron, për qëllimet e realizimit të Projektit, strukturat e mëposhtme, me termat e referencës, personelin dhe burimet e tjera të pranueshme për Bankën, gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të Projektit:

a) Komitetin drejtues të Projektit, të krijuar në përputhje me seksionin 4.01(a) të Marrëveshjes fillestare të Huas.

b) Ekipin e Menaxhimit të Projektit, të krijuar pranë MBZHR-së, përgjegjëse për menaxhimin e përditshëm të Projektit, koordinimin e partnerëve të Projektit, Bankën, dhe bashkë-financuesit, monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të Projektit: përgatitjen e planit dhe të buxhetit vjetor të zbatimit, përditësimin e Planit të Prokurimeve, përgatitjen e Strategjisë së Prokurimit të Projektit për Zhvillim dhe dokumenteve të prokurimit; përgatitjen e raporteve financiare dhe të progresit dhe mirëmbajtjen e arkivimit të dokumenteve të Projektit.

B. Manuali Operacional i Projektit

1. Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së:

a) Do të zbatojë Projektin dhe mundëson realizimin e Projektit, në përputhje me manualin e zbatimit të projektit, të cilin Banka e ka konfirmuar si të pranueshëm (Manuali Operacional i Projektit); dhe

b) Nuk do të ndryshojë, fshijë ose heqë asnjë pjesë të Manualit Operacional të Projektit, pa miratimin paraprak të Bankës.

C. Masat e sigurisë

Mbrojtja e mjedisit dhe rivendosja

1. Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së, do të realizojë Projektin dhe do të mundësojë kryerjen e veprimeve të mëposhtme: a) zbatimin e Dokumentit të Kuadrit të Mbrojtjes Mjedisore dhe Sociale; b) përgatitjen dhe dërgimin në Bankë për miratim të planeve të menaxhimit të mbrojtjes mjedisore dhe sociale të zonave specifike (përfshirë dispozitat në lidhje me menaxhimin e dëmtuesve të bimëve) në përputhje me Dokumentin e Kuadrit Mjedisor dhe Social; dhe c) zbatimin e planeve të lartpërmendura për menaxhimin mjedisor dhe social të zonave të caktuara, të miratuara nga Banka, të gjitha në një mënyrë të pranueshme për Bankën dhe të nevojshme për të siguruar që Projekti është zbatuar në përputhje me praktikat dhe standardet e qëndrueshme mjedisore.

2. Pa u kufizuar në paragrafin 1 të këtij seksioni I.C, Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së nuk do të fillojë apo lejojë tenderimin për punimet sipas Projektit derisa Banka të ketë miratuar planin specifik të menaxhimit mjedisor dhe social të lidhur me këto punime, në përputhje me dispozitat e përmendura në paragrafin 1.

3. Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së do të:

a) Marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar, në masën që është e mundur, çdo humbje jovullnetare të strehimit, humbje të aseteve produktive ose aksesit në asetet produktive, ose humbje në të ardhura ose mjete të tjera jetese të njerëzve, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme, gjatë realizimit të Projektit; dhe

b) Në rastet ku zbatimi i Projektit ose modifikimi/përfundimi i çdo projektimi ose pune të Projektit, çojnë në zhvendosje të personave dhe para fillimit të punimeve të lidhura me këtë zbatim, modifikim ose përfundim, i jep Bankës për rishikim dhe miratim, një plan veprimi rivendosjeje në një zonë specifike, të

përgatitur në përputhje me parimet dhe procedurat e parashikuara në Kuadrin e Politikave të Rivendosjes dhe, më pas, zbaton në mënyrë të pranueshme për Bankën (ku përfshihet pagimi i plotë i kompensimit për të gjithë personat e zhvendosur, me përjashtim të rasteve kur bihet dakord ndryshe me Bankën) këto plane veprimi rivendosjeje për zonat specifike, siç janë miratuar nga Banka.

4. Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së do të:

a) Sigurojë dhe mundësojë vënien në dispozicion të Bankës, për miratimin e saj paraprak, të çdo propozimi, modifikimi ose heqje dorë të plotë ose të pjesshme, të ndonjë nga sa më poshtë: i) Dokumentit të Kuadrit të Sigurimit Mjedisor dhe Social; ii) planeve për menaxhimin mjedisor dhe social për zona specifike, të përgatitura dhe të miratuara nga Banka në përputhje me paragrafin 1, të seksionit I.C; iii) Kuadrit të Politikave të Rivendosjes; dhe iv) planet e veprimit të rivendosjes në zonat specifike, të përgatitura dhe të miratuara nga Banka në përputhje me paragrafin 3, të këtij seksioni I.C; dhe

b) Zbatojë ose mundësojë zbatimin vetëm të atyre modifikimeve ose heqjeve dorë, siç do të jetë rënë dakord nga Banka.

5. Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së, do të:

a) Sigurojë politika dhe procedura të përshtatshme për t'iu mundësuar të monitorojnë dhe vlerësojnë, në përputhje me udhëzimet e pranuara nga Banka, zbatimin e: i) Kuadrit të Mbrojtjes Mjedisore dhe Sociale; ii) planeve të menaxhimit mjedisor dhe social për zonat specifike, të miratuara nga Banka në përputhje me paragrafin 1 të këtij seksioni I.C; iii) Kuadrin e Politikave të Rivendosjes; dhe iv) planet e veprimit të rivendosjes për zona specifike, të përgatitura dhe të miratuara nga Banka në përputhje me paragrafin 3 të këtij seksioni I.C, dhe arritjen e objektivave të secilit nga instrumentet e sipërpërmendura; dhe

b) Përgatisë, sipas termave të referencës të kënaqshme për Bankën, dhe i jep Bankës rezultatet e aktiviteteve të monitorimit dhe të vlerësimit në lidhje me secilin nga instrumentet e përmendura në nën-paragrafin "a" më sipër.

Siguria e digave

6. Për të garantuar sigurinë e digave të cilat do të rehabilitohen sipas pjesës 1 të këtij Projekti dhe/ose të përfshira në sistemet e përzgjedhura të ujitjes, Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së do të:

a) Mbajë Panelin e Ekspertëve të Sigurisë së Digave, me kualifikime, potencialet dhe përvojë të pranueshme për Bankën dhe i cili (Paneli i Ekspertëve të Sigurisë së Digave) është përgjegjës për këshillimin e MBZHR-së për çështje që lidhen me sigurinë e këtyre digave; përfshirë rishikimin e projekteve të zbatimit për rehabilitimin e digave, monitorimin dhe raportimin për punimet rehabilituese të këtyre digave dhe përfundimin e punimeve të përmendura më sipër;

b) Përpara fillimit të tenderimit të punimeve që do të realizohen si pjesë e Projektit:

i. përgatit ose merr masa për përgatitjen, në përputhje me një kuadër të pranueshëm për Bankën, plane të detajuara dhe me afate kohore të qarta, në lidhje me digat e përmendura më sipër, për: A) mbikëqyrjen e ndërtimit dhe sigurimin e cilësisë; B) instrumentet; C) operimin dhe mirëmbajtjen; dhe D) përgatitjen për emergjencat; dhe

ii. përfundon planet e lartpërmendura, duke pasur parasysh komentet e Bankës.

c) Më pas, i zbaton ose merr masa për zbatimin e këtyre planeve, të cilat janë pranuar nga Banka; dhe

Pas përfundimit të punimeve të ndërtimit në digat përkatëse, cakton profesionistë të pavarur të kualifikuar për realizimin e inspektimeve periodike të sigurisë për digat e përmendura më sipër.

Seksioni II. Raportimi, vlerësimi dhe monitorimi i Projektit

Huamarrësi, nëpërmjet MBZHR-së, i paraqet Bankës çdo raport të Projektit jo më vonë se dyzet e pesë ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik që mbulon semestrin kalendarik.

Seksioni III.Tërheqja e fondeve të Huas

A. Të përgjithshme

Pa u kufizuar nga dispozitat e nenit II të kushteve të përgjithshme dhe në pajtim me letrën e informacionit për disbursimin dhe financimin, Huamarrësi mund të tërheqë fondet e Huas, për të: a) financuar shpenzimet e pranueshme; dhe b) paguar tarifën e Huas në shumën e caktuar dhe, sipas rastit, deri në përqindjen e përcaktuar kundrejt çdo kategorie të tabelës së mëposhtme:

Kategoria	**Shuma e Huas shtesë (shprehur në EURO)**	**Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përjashtuar taksat)**

1. Mallrat, punimet, shërbimet jokonsulente, shërbimet e konsulentëve, dhe trajnimet sipas Projektit me përjashtim të pjesës 3.	22,942,500 -	100%
2. Tarifa fillestare	57,500	Shuma e paguar në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshje në përputhje me seksionin 2.07 (b) të kushteve të përgjithshme
TOTALI	23,000,000	

B. Kushtet e tërheqjes; periudha e tërheqjes.

Pa cenuar dispozitat e pjesës A më sipër, nuk do të kryhet asnjë tërheqje:

a) Për pagesa të bëra para datës së nënshkrimit;

b) Derisa shumat e caktuara në kategorinë 1(b) të tabelës sipas nenit IV.A. 2 të Marrëveshjes fillestare të Huas të jenë disbursuar plotësisht;

c) Në lidhje me pjesët e mëposhtme të Projektit fillestar (i) aktivitetet e pjesës 3 të Projektit; dhe pjesës 2(a) (i) të Projektit.

2. Data e mbylljes është 31 maj 2020.

PJESA 3

Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesës së principalit të Huas dhe përqindjen e shumës së përgjithshme të principalit të Huas të pagueshme çdo datë pagese principali (pjesa e këstit).

Data e pagimit të principalit	Pjesa e këstit
Në çdo datë 1 maj dhe 1 nëntor, duke filluar më 1 maj 2025. deri më 1 maj 2042.	2.78%
më 1 nëntor 2042	2.70%

SHTOJCË

Seksioni I. Përkufizime

1. "Udhëzimet antikorrupsion", për qëllimet e paragrafit 5 të shtojcës së kushteve të përgjithshme, janë "Udhëzimet për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e BNZHR-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-s", datë 15 tetor 2006, të rishikuara në janar të vitit 2011 dhe në versionin e datës 1 korrik 2016.

2. "Kategori" është kategoria e parashikuar në tabelën në seksionin III A të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

3. "Personat e zhvendosur" janë personat, të cilët, për shkak të ekzekutimit të Projektit, kanë qenë objekt ose do të jenë objekt i ndikimeve të drejtpërdrejta ekonomike dhe sociale të shkaktuara nga: a) marrja jo vullnetare e tokës, e cila çon në: i) transferim ose humbje strehimi; ii) humbje të aseteve ose të aksesit në asete; ose iii) humbje të burimeve të të ardhurave ose të mjeteve të jetesës, pavarësisht nëse këta persona duhet ose jo të lëvizin në një vend tjetër; ose b) kufizim jovullnetar në aksesin në zonat e përcaktuara ligjërisht si parqe dhe në zonat e mbrojtura, të cilat ndikojnë negativisht në jetën e këtyre personave.

4. "Dokumenti i Kuadrit të Mbrojtjes Mjedisore dhe Sociale" është Kuadri i Mbrojtjes Mjedisore dhe Sociale, datë 1 tetor 2017, i cili përcakton politika dhe procedura për shqyrtimin e aktiviteteve të propozuara të Projektit (duke përfshirë rehabilitimin dhe modernizimin e digave dhe të sistemeve të ujitjes dhe kullimit) dhe për përgatitjen e planeve të zonave specifike për menaxhimin mjedisor dhe social gjatë zbatimit të projektit, siç dokumente të tilla mund të ndryshohen herë pas here në marrëveshje me Bankën.

5. "Kushtet e përgjithshme" janë "Kushtet e përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim", datë 12 mars 2012.

6. "MBZHR" është Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural të Huamarrësit ose çdo pasues i ardhshëm i saj.

7. "Këshilli Kombëtar i Ujit" është Këshilli Kombëtar i Ujit, i cili është organi qendror vendimmarrës për menaxhimin e burimeve ujore, i krijuar në përputhje me ligjin nr. 8093, datë 21 mars 1996.

8. "Huaja fillestare" është Huaja nr. 8211-AL e dhënë nga Banka për të asistuar në financimin e Projektit fillestar (që përkufizohet më poshtë).

9. "Marrëveshja e Huas fillestare' është marrëveshja për financimin e Projektit fillestar (që përkufizohet më poshtë) ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës, të datës 14 dhjetor 2012.

10. "Projekti fillestar' është Projekti i përshkruar në Marrëveshjen të Huas fillestare.

11. "Paneli i Ekspertëve të Sigurisë së Digave" është paneli prej 5 (pesë) ekspertësh të fushave të ndryshme teknike, të lidhura me aspektet e sigurisë së digave në sistemet e përzgjedhura të ujitjes, panel i krijuar në përputhje me kushtet e punës të pranueshme për Bankën, në mënyrë që të shqyrtoje çështjet që lidhen me sigurinë e digave dhe këshillohet me MBUMK-në në lidhje me to.

12. "Rregulloret e p rokurimit" janë, për qëllimet e paragrafit 85 të shtojcës së kushteve të përgjithshme, "Rregulloret e prokurimeve të Bankës Botërore për Huamarrësit financimi i projekteve të investimeve", të muajit korrik 2016.

13. "PPSD" është Strategjia e Prokurimeve të Projektit për Zhvillim, dokumenti strategjik për Projektin, i përgatitur dhe miratuar nga Huamarrësi më 24 tetor 2017, i cili përshkruan realizimin e prokurimeve të projekteve të financuara nga Banka Botërore.

14. "Manuali i zbatimit të Projektit" është manuali për veprimet e projektit, i përgatitur në përputhje me paragrafin 1, të seksionit V, të pjesës 2, të kësaj Marrëveshje dhe i konfirmuar si i kënaqshëm nga Banka, i miratuar nga Huamarrësi në përputhje me seksionin 4.01(d) të kësaj Marrëveshjeje.

15. "Kuadri i Politikave të Zhvendosjes" është kuadri i politikave të zhvendosjes, datë 9 tetor 2012, i cili përcakton politikat dhe procedurat për marrjen e tokës dhe të aseteve të tjera, zhvendosjen, kompensimin dhe rehabilitimin e personave të zhvendosur dhe procedurat për përgatitjen e planeve të zhvendosjes për zonat specifike, kurdo që kërkohet gjatë zbatimit të Projektit, siç mund të ndryshohet herë pas here me miratimin paraprak të Bankës.

16. "Agjencitë e baseneve të lumenjve" janë agjencitë e baseneve të lumenjve të krijuara në përputhje me ligjin nr. 8093, datë 21 mars 1996, me përgjegjësi të lidhura me burimet ujore, duke përfshirë mbajtjen e inventarëve dhe hartimin e propozimeve për investime dhe menaxhim ,duke u fokusuar në reduktimin e ndotjes dhe trajtimin e problemeve të tjera.

17. "Këshillat e baseneve të lumenjve" janë këshillat e baseneve të lumenjve të krijuara në përputhje me ligjin nr. 8093, datë 21 mars, 1996, me përgjegjësitë që janë përcaktuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit.

18. "Sistemet e përzgjedhura të ujitjes, janë: a) digat e mëposhtme dhe sistemet e tyre përkatëse të ujitjes dhe të kullimit: T'Plani, Vranishti 2, Tregtani 2, Tregtani 3, Murriz Thana, Kurjani, Strumi, Zharreza, Slanica, Belesova, Duhanasi, Staravecka, Leminoti, dhe Koshnica; b) sistemet e ujitjes dhe kullimit të Bushatit dhe Xarrës; si dhe c) çdo digë dhe/ose sistem ujitje dhe kullimi e rene dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës.

19. "Data e nënshkrimit' është e fundit e dy datave në të cilat Huamarrësi dhe Banka kanë nënshkruar këtë Marrëveshje dhe një përcaktim i tille zbatohet për të gjitha referencat te "data e Marrëveshjes së Huas" në kushtet e përgjithshme.

20. "Trajnim" janë shpenzimet që do të kryhen për blerjen e materialeve trajnuese, qiranë e ambienteve të trajnimit, dietat dhe udhëtimet përkatëse të trajnerëve në lidhje me Projektin.